



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:129746
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05476157

C.A.P.nr.1458/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.Z. nga fshati R., Komuna Sh., të cilin me autorizim e përfaqëson av Xh. M. nga F., kundër Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson Lulzim Muharremi, për pagesën e diferencës në pagë dhe shpenzimet e procedurës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorës, Komuna e Shtimes, ushtruar përmes përfaqësueses së saj me autorizim, Lulzim Muharremi, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil E.nr.674/23 i datës 19.06.2023, me datë **20.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e debitorit Komuna e Shtimes, ushtruar përmes të autorizuarës së saj, Lulzim Muharremi, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, me numër E.nr.674/2023, i datës 19.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar, E.nr.674/2023, i datës 19.06.2023, ka vendosur si në vijim:

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i përfaqësuesit të debitorit Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit, i ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E.nr.674/23, të datës 08.05.2023, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit E.nr.674/23, i datës 08.05.2023.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Komuna e Shtimes, përmes të autorizuarës së saj Lulzim Muharremi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që ankesa e debitorit të miratohet si e

bazuar të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe aprovet prapësimi, ose aktvendimi ankimor të priset dhe çështja t'i kthehet në ri-gjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e debitorit nuk ka ushtruar kreditori.

Gjykatësi Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar si dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, 17 dhe 77 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika b) të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit Komuna e Shtimes, ushtruar përmes të autorizuarit të saj, Lulzim Muharremi, rezulton e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kreditori N. Z. nga fshati R./Komuna e Sh., përmes të autorizuarit të tij, avokat Xh. M. nga Ferizaj, me datën 03.03.2023, pranë Organit Përmbartues-Gjykatës Themelore në Ferizaj, ka ushtruar propozim për përmbartim kundër debitorit Komuna e Shtimes, në bazë të dokumentit përmbartimor-Pajtimit Gjyqësor sipas aktvendimit në lëndën me numër të SMIL-it 2021:129746, të datës 01.11.2022, nga ku është dakorduar debitori që kreditorit në emër të shpërblimit për licencim dhe gradim t'ia paguajë shumën totale të kompensimit prej 3,125.25 euro, si dhe shpenzimet e procedurës 234 euro, sipas afateve të përcaktuara në këtë pajtim gjyqësor, të cilin gjykata e ka miratuar me aktvendimin e nxjerrë në seancë gjyqësore të datës 01.11.2022.

Gjykata si organ përmbartues me Aktvendimin E.nr. 674/23, të datës 08.05.2023, ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër Aktvendimit për Lejimin e Përmbartimit, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim debitori Komuna e Shtimes, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi Aktvendimin për Lejimin e Përmbartimit me arsyetimin se Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev.nr.404/2022, duke vendosur lidhur me revizionin e Komunës së Gjilanit, e ka refuzuar kërkesëpadinë për pjesën e kompensimit të pagës në emër të gradimit apo kualifikimit dhe se ky aktgjykim duhet të shërbejë si precedent edhe për rastet tjera të ngjajshme, mbi bazën e këtyre arsyeve gjykatës i ka propozuar aprovimin e prapësimit dhe shfuqizimin e aktvendimit për lejimin e përmbartimit, si dhe refuzimin e propozimit për përmbartim.

Kreditori, N. I., përmes të autorizuarit të tij, avokat Xh.M. nga F., në afatin e caktuar ligjor, ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të ushtruara në prapësim, me propozim për gjykatën që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe Aktvendimi për Lejimin e Përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të prapësimit nga debitori dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka nxjerr aktvendimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata me rastin e shqyrtimit të prapësimit të përfaqësuesit të debitorit, gjeti se me rastin e nxjerrjes së aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore, janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për caktimin e përmbarimit të propozuar dhe prapësimi i përfaqësuesit të debitorit është në tërësi i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të debitorit në prapësim se Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e Rev.nr.404/2022, duke vendosur mbi revizionin e Komunes së Gjilanit, Drejtoria e Arsimit, ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë, në pjesën e kompensimit të pagesë në emër të gradimit apo të kualifikimit. Ky aktgjykim shërben si precedent edhe raste tjera të ngjashme, gjykata këtë pretendim e konsideron të pa bazuar për arsye se gjykata nuk mund të merr për bazë aktgjykimin e cekur të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, sepse ky aktgjykim siç shihet është nxjerrë për çështje tjera juridike kontestimore dhe nuk ka të bëjë fare me pajtimin gjyqësor në rastin konkret dhe përderisa në rastin konkret nuk kemi ndonjë aktgjykim të nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë por edhe nga gjykata e shkallës së dytë për pajtimin gjyqësor 2021:129746, të datës 01.11.2022, për Gjykatën Themelore në Ferizaj pajtimi gjyqësor i cekur më lart ende konsiderohet dokument përmbarimor i paraparë në nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së.

Përveç tjerash, pajtimi gjyqësor 2021:129746, i datës 01.11.2022, është i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, për shkak se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e përfaqësuesit të debitorit në prapësim, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen në prapësimin e përfaqësuesit të debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i përfaqësuesit të debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa aktvendimi mbi caktimin e përmbarimit E.nr.674/23, i datës 08.05.2023, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të drejtë, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, konstatohet se procedura përmbarimore ka filluar në bazë të dokumentit përmbarimor dhe atë pajtimin gjyqësor sipas aktvendimit në lëndën me numër të SMIL-it 2021:129746, të datës 01.11.2022, nga ku është dakorduar debitori që kreditorit në emër të shpërblimit për licencim dhe gradim t'ia paguajë shumën totale të kompensimit prej 3,125.25 euro, si dhe shpenzimet e procedurës 234 euro, sipas afateve të përcaktuara në këtë pajtim gjyqësor, dhe se nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori brenda

afatit të përcaktuar me marrëveshje më së largu deri me datën 31.12.2022, nuk ka përmbushë detyrimin e tij të dakorduar për kreditorin.

Gjykatës së Apelit, nga përmbajtja e aktvendimit të ekzaminuar me ankesë, i rezultuan të pa bazuara pretendimet ankimore të përfaqësueses së debitorit, se aktvendimi i goditur me ankesë është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) të LPK-së, ngase aktvendimi i kundërshtuar me ankesë sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, si në përmbajtje, dispozitiv dhe arsyetim është i drejtë dhe përmban të gjitha arsyet vendimtare për një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në provat si në shkresat e lëndës. Në aktvendimin e ankimuar, janë dhënë arsye të qarta dhe bindëse lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase, në bazë të nenit 22 par.1, pika 1.1, në lidhje me nenin 23 par.1, si dhe nenin 27 par.1 të Ligjit për Procedurë Përmbarimore, dokumenti përmbarimor mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi dhe atë pajtimi gjyqësor i arritur sipas lëndës me numër të SMIL-it 2021:129746, të datës 01.11.2022, i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument përmbarimor, është i përshtatshëm për përmbarim, dhe se debitori në bazë të nenit 8 dhe 245 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 detyrohet të përmbushë detyrimin e tij karshi kreditorit, ashtu që, në rastin konkret debitori me asnjë provë nuk ka arritur që përmes prapësimit të ushtruar të vërtetoj ndonjërin nga bazat e përcaktuara me nenin 69, 71 dhe 73 të LPP-së.

Të pabazuara, një ashtu rezultojnë pretendimet e përfaqësueses së debitorit së Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev.nr. 404/2022, duke vendosur lidhur me revizionin e Komunës së Gjilanit, e ka refuzuar kërkesëpadinë për pjesën e kompensimit të pagës në emër të gradimit apo kualifikimit dhe se ky aktgjykim duhet të shërbej si precedent edhe për rastet tjera të ngjajshme, kjo për faktin se në rastin konkret edhe pse ky aktgjykim ka të bëjë me një komunë tjetër dhe palë tjera, edhe poqëse vie në shprehje i njëjti aktgjykim në zbatim eventual të tij, për faktin se në rastin konkret kreditori me debitorin kanë arritur ujdë gjyqësore me datën 01.11.2022 dhe e njëjta brenda afatit partitiv të dakorduar mes palëve nuk është përmbushë nga debitori, dhe nuk ka prova se ujdë gjyqësore e datës 01.11.2022, është anuluar apo shfuqizuar me ndonjë aktgjykim eventual të gjykatës, pretendimi i debitorit në rastin konkret nuk rezulton i bazuar dhe ky aktgjykim i pretenduar nga ai nuk mund të shërbej si bazë për aprovimin e prapësimit dhe ankesës siç i njëjti e ka parashtruar, prandaj, edhe në rastin konkret, meqë, nuk qëndrojnë asnjëra nga shkaqet për prapësim të përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, si dhe asnjëra nga bazat e përcaktuara në ankesë sipas nenit 17 dhe 77 të LPP-së, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret debitori me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të vërtetoj bazueshmërinë e pretendimeve ankimore, andaj si të tilla edhe u refuzuan si të pa bazuara.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, e në mbështetje të nenit 17, 77 të LPP-së, në lidhje me nenin 194, 208, 209 pikat b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1458/2023, me datë 20.03.2024

Gjyqtari Individual
Besnik Feka